

## **Hapet Thirrja për Bursa për stafin akademik në Programin Erasmus + në Universitetin e Bolonjës, Itali**

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për stafin akademik të Universitetit të Tiranës në Universitetin e Bolonjës në Itali.

### **Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie

### **Kohëzgjatja e bursave:**

- Shkëmbimi i stafit akademik për mësimdhënie (5 + 2 ditë)

### **Fushat e studimit:**

- Arte dhe shkenca humane;
- Shkenca Sociale, Gazetari dhe Komunikim;
- Administrim Biznesi dhe Drejtësi;
- Shkenca Natyrore, Matematikë dhe Statistikë

Për më shumë informacion mbi Universitetin e Bolonjës klikoni në adresën:

<http://www.unibo.it>

### **Bursat përfshijnë:**

- Kompensimin ditor (140 EUR në ditë për stafin);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

<b>DISTANCA E UDHËTIMIT</b> ( <a href="http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm">http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm</a> )	<b>Kompensimi</b>
<b>Midis 100 dhe 499 KM</b>	180 EUR
<b>Midis 500 dhe 1999 KM</b>	275 EUR
<b>Midis 2000 dhe 2999 KM</b>	360 EUR
<b>Midis 3000 dhe 3999 KM</b>	530 EUR
<b>Midis 4000 dhe 7999 KM</b>	820 EUR
<b>8000 KM ose më shumë</b>	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)

Dokumentat e nevojshme për aplikim **për stafin akademik për mësimdhënie:**

- CV+ lista e publikimeve (në gjuhën angleze/italiane);
- Kopje e mjetit të identifikimit (ID/pasaport);
- Letër motivimi (në gjuhën angleze/italiane);
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);
- Certifikata e gjuhës së huaj (niveli minimal i kërkuar për gjuhën është B2);
- Plani i mobilitetit për mësimdhënie.

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Trajnim klikoni në adresën:  
[http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Teaching\\_Mobility\\_Plan.pdf](http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Teaching_Mobility_Plan.pdf)

-Letër Ftesë nga një pedagog i Universitetit të Bolonjës, me të cilin aplikanti kontakton paraprakisht dhe jepet pëlqimi që ai të mbështesë aplikantin gjatë shkëmbimit në Universitetin e Bolonjës.

**Afati për aplikim:** 7 Shtator 2018

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në zyrën për marrëdhëniet me jashtë në adresën [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al)

Universiteti i Tiranës ju uron Suksese në aplikim!